

INSPEKTORATI SHITËTOR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI QERSHOR 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	01.06.2026	Dëshirojmë të kryejmë analizat dhe testimet e vajit termiozohues për autotransformatorin tonë. Për referencë, po ju dërgojmë specifikimet kryesore të pajisjes Prodhuesi: TAMINI Energy Transformers Tipi: Autotransformator Trifazor (ATR 250.230A/135T) Fuqia Nominale: 250 MVA Viti i prodhimit: 2021 Konkretisht, jemi të interesuar për realizimin e këtyre analizave: Pamja e jashtme dhe ngjyra (Aspetto e colore) Tensioni i shpimit dielektrik (Tensione di rottura dielettrica - BDV) Përmbajtja e ujit / lagështia (Contenuto d' acqua / umidità) Aciditeti total (Acidità totale - TAN) Faktori i humbjeve dielektrike / Tangjent delta (Fattore di dissipazione / tg δ) Tensioni ndërfaqësor (Tensione interfacciale) Përmbajtja e grimcave të ngurta (Contenuto di particelle solide) Dendësia dhe viskoziteti (Densità e viscosità) Analiza e gazeve të tretura - DGA (Analisi gas disciolto: SCOS, SCO_2\$, SO_2\$) Ju lutemi na konfirmoni nëse i mundësoni këto testime në laboratorin tuaj dhe na dërgoni një ofertë financiare, së bashku me afatet e nevojshme për nxjerrjen e raporteve teknike.	02.06.2026	Në vijim te email-it tuaj për informacion rreth kryerjes së analizave cilësore të vajit termiozohues për autotransformatorin, ju bëjmë me dije se: Në Laboratorin tonë kryhen analizat e çdo lloji vaji lubrifikant me metodën standarde S SH ISO 8681:1986. Treguesit që analizohen janë të njëjtë për të gjithë vajrat. Bashkëngjitur keni dhe tabelën me treguesit që analizohen në Laboratorin tonë shoqëruar me metodat standarde përkatëse në fuqi. Për sa i përket tarifave të analizimit, ato do t'i gjeni në Urdhër Nr.6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse".	E Plotë	0
2	01.06.2026	Ne, banorët e një pallati, ju drejtohem me këtë ankesë për të denoncuar një subjekt/dyqan që ushtron aktivitet shirjeje dhe mbushjeje bombolash gazi në katin përde të pallatit tonë, pa kushte sigurie dhe dyshohet pa licencat përkatëse. Ky aktivitet përben rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e banorëve, pasi bombolat e gazit mbahen dhe tregtohen në kushte të papërshtatshme teknike, pranë ambienteve të banimit. Gjithashtu mungojnë masat bazë të sigurisë kundër zjarrit dhe shpërthimit. Kërkojmë nga ana juaj: Verifikim urgjent të aktivitetit të këtij subjekti; Kontroll të dokumentacionit dhe licencave përkatëse; Marritjen e masave administrative dhe ligjore sipas legjislacionit në fuqi; Garantinë e sigurisë së banorëve të pallatit.	11.6.2026	Në përgjigje të shkresës të protokolluar me Nr.4723 Prot më datë 02.06.2026, ardhur me email pranë ISHTI, lidhur me ankesën për aktivitetin e paligjshëm dhe të rrezikshëm me bombula gazi në ambient banimi ju bëjmë me dije se u bë kontroll në terren nga inspektorët e Inspektoriatit Shërbitor Teknik Industrial sipas të cilit rezultoi se: Subjekti i cili dyshohet se ushtron aktivitetin e paligjshëm dhe të rrezikshëm me bombula gazi në ambient banimi, nga kontrolli i ushtruar rezultoi se ishte i mbyllur. Gjithashtu u krye evidencimi përseri i subjektit dhe në ditët pasardhëse në subjekt dhe rezultoi përseri po i mbyllur, gjithashtu u bë dhe verifikimi për numërin e NIPT në QKB dhe nuk rezultoi i regjistruar si subjekt. Nga ana e inspektorëve është bërë komunikimi me personat përgjegjës, dhe u bë evidencimi në ambientin e brendshëm të subjektit, ku rezultoi se subjekti dispononte disa bombula Gln (Gaz i Lëngshëm i Naftës) të cilat rezultuan të ishin jashtë përdorimit dhe nuk dispononin Gln brenda tyre, për cilat personi përgjegjës u shpreh se ambientin e përdorte për magazinim të sendeve personale. Përsa më sipër nga evidencimi i kryer nuk është parë asnjë pajisje e cila mund të përdorej ose mund të kryente funksion për mbushjen e bombolave Gln. Duke marrë shkas nga kjo situatë personit përgjegjës ju bë i mundur informimi në lidhje me kushtet tekniko-ligjore sipas Ligjit Nr. 32, datë 24.03.2016, "Për Garantinë e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion", VKM-të Nr.212, datë 16.03.2016, "Për Përcaktimin e Kushteve dhe të Rregullave Teknike për Përpunimin e Bombolave të mbushura me GLN.	E Plotë	0
3	12.06.2026	Jemi njohur bashkëlidhur me urdhrin e ekzekutimit për faturën tatimore perkatese. Ju lutemi të rishihni dhe njehere kartelat tuaja pasi ne nuk na rezulton asnje detyrim pa paguar, pasi marrim kartelen nga ju dhe paguajme totalte, kemi qene shume korrekt dhe per me teper kemi marr dhe vertetime nga ISHTI te cilat ne kushtet e debise nuk leshohen. Per sa me siper ju lutemi dhe nje rikontroll pasi ne kartelen tone detyrimet jane te shlyera sidomos per vitin 2025 jane 0 dhe nuk ishte as e nevojshme dergimi per ekzekutim i nje fature tatimore me vlere te vogel.	15.06.2026	Në vijim të kërkesës për verifikim në lidhje me Urdhrin e Ekzekutimit të gjykatës mbi faturën tatimore, ju bëjmë me dije se: Detyrimet monetare të lindura, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse përbejnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor. Në momentin e depozitimit të kërkesës në gjykatë, detyrimi objekt i saj ka rezultuar i pashlyer dhe afati ligjor i likuidimit vullnetar të tij ka përfunduar. Shlyerja e detyrimit pas fillimit të procedurave gjyqësore nuk çënon ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra deri në atë moment dhe nuk krijon përgjegjësi për institucionin lidhur me kostot apo pasojat që rrjedhin nga mos shlyerja në afat e detyrimit. Dërgimi në gjykatë është një detyrim ligjor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke qenë se detyrimi kryesor është likuiduar nga ana juaj, në këtë rast do të merren masat për pushimin e mëtejshëm të ekzekutimit përbarimor. Njëkohësisht, ju sjellim në vëmendje që në marrëdhëniet e ardhshme të respektori afatet ligjore të përcaktuara për shlyerjen e detyrimeve financiare, pasi mosrespektimi i tyre çon në ndjekjen e procedurave administrative dhe gjyqësore për realizimin e tyre sipas kërkesave të ligjvënësit.	E Plotë	0
4	15.06.2026	Pershendetje ju lutem si mund te aplikoj per sherbimin e meposhtem: Vertetim që subjekti nuk është penulizuar gjate vitit 2025	15.06.2026	Aplikimi kryhet ne e- albania , tek sherbimet sipas institucionit perkatës , Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ISHTI , klikon vertetim me emertimin " respektimin e kerkesave te standardit teknik te naftes dhe nenprodukteve te saj. Hapat si me poshte: Hapat e procedurës - Identifikohuni si biznes në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Vërtetim për respektimin e kërkesave të standardit teknik të naftës dhe nënprodukteve të saj"; - Klikoni butonin" Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; - Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 10 ditë	E Plotë	0
5	24.06.206	Në kuadër të procedurave të prokurimit që kryhen , është dërguar shkresë pranë institucionit tuaj, me qëllim kryerjen e disa verifikimeve sipas parashikimeve ne legjislacionin e prokurimeve publike. Lutemi per nje përgjigje nga ana juaj pasi aktualisht insitucioni ka pezulluar procesin e vleresimit per proceduren "Blerje karburant per automjete, gazoil dhe benzine".	24.06.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj lidhur me kërkesën për informacion ju informojmë se kërkesa është trajtuar nga ISHTI dhe është dërguar me shkresë zyrtare në rrugë postare pranë.	E Plotë	0